


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për Zonat Ekonomike , Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.10.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR VENDOSJE TË BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË ZK QYLAGË –FAZA E DYTË

I. Me këtë Vendim fillon procedura për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e dytë.

II.OBLIGOHET, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të shpallë Konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e dytë.

III. Forma e konkursit publik, të përgaditet konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

IV. Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit.

V. Parcelat kadastrale të cilat do të ipen në shfrytëzim në fazën e dytë janë si vijon:

Nr.	Numri i njësisë kadastrale	Lloji i pronës	Zona Kadastrale	Sipërfaqja
1.	P-71409090-00476-4	Pronë shoqërore e Komunës së Lipjanit	Qylagë	17698 m ²

2.	P-71409090-00476-5	Pronë shoqërore e Komunës së Lipjanit	Qylagë	9433 m ²
----	--------------------	---------------------------------------	--------	---------------------

VI. Pronat e paluajtshme që do tu ipet në shfrytëzim subjekteve ekonomike do të jetë në afat prej 99 viteve.

VII. Bizneset të cilat do të përzgjidhen konform procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore në tri (3) vitet e para nga dita e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas tri viteve do të paguajnë si në tabelën në vijim:

Vitet e Operimit	Çmimi m ² – Në vit	Çmimi për 1 Ha – Në vit
Në 3 (tri) vitet e para	0.00 euro	00.00 euro
Prej vitit të 4 (katërt) deri në vitin e 7 (shtatë)	0.07 euro	700.00 euro
Prej vitit të 8 (tetë) deri në vitin e 10 (dhjetë)	0.11 euro	1 100.00 euro
Prej vitit të 11 (njëmbëdhjetë)	0.125 euro	1 250.00 euro

VIII. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

IX. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Nr. 15-300/01-61655

Lipjan, më 30.10.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

